



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 0682027818

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 6334

Tirane më 15/07/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021053950441835816

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU



DATE 15/07/2021
NR REP 6334



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 15/07/2021, perpara meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

DEKLARUES:

Shpëtim Shijaku, atësia Sulejman, amësia Rukije, shtetas Shqiptar, lindur në Krujë dhe banues në TIRANË, me adresë Perlat Rexhepi; Nd. 8; H. 6; Ap. 49; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 01/05/1962, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033855702 dhe nr. personal G20501079L, **ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "Mediterranean Wave" Shpk;**

i cili deklaroi se ka nenshkruar me vullnet te lire e te plote, dokumentin bashkelidhur: **Statut i shoqerise "Mediterranean Wave" Shpk me date 08/07/2021.**

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
JULIAN ZHELEGU



STATUTI
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MEDITERRANEAN WAVE” SH.P.K.

Sot, me date 08/07/2021 (dymije e njezet e nje), te pranishem:

Shpëtim Shijaku, i biri i **Sulejmanit**, shtetas shiptar, lindur ne Kruje dhe banues në Tirane me datë me 01/05/1962, mbajtës i Leternjoftimit Nr.033855702, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 1 kuote, e cila korrespondon me **100 %** të kapitalit të shoqërisë;

I cili ne cilesine e ortakut, me vullnet te lire dhe te plote, bazuar ne legjislacionin shqiptar si:

- Kushtetuta e Republikes se Shqiperise;
- Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
- Ligji Nr. 9901, Dt. 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”;
- Ligji Nr. 9723, Dt. 03.05.2007, “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

Themelon shoqerine, ne formen e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, (sh.p.k), si nje shoqeri e te drjetes shqiptare, e cila do te funksionojë ne perputhje me ligjin shqiptar dhe ne perputhje me kete Statut.

NENI 1
EMERTIMI

Themelohet nje shoqeri e se drejtes shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin emërtimin **“Mediterranean Wave” sh.p.k.**

NENI 2
SELIA

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rruga “Donika Kastrioti”, Pallati Nr. 14, Kati 3, Apartamenti 6, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria, me vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të hapë seli dytësore, filiale, zyra përfaqësimi, degë ose agjensi si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Vendbanimi i ortakeve për të gjitha marrëdhëniet me shoqërinë është ai që rezulton nga akti i themelimit ose nga njoftimet e mëvonshme të tyre dërguar pranë selisë së shoqërisë.

NENI 3
OBJEKTI

Objekti i Shoqërisë është:

Projektimi, ndërtimi, venia në shfrytëzim e një kompleksi turistik, përfshirë strukturën e hotelërisë dhe e objekteve turistike. Shitja e objekteve me destinacion rezidencial dhe/ose

administrimi i tyre, si dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit si dhe cdo veprimtari tjetër plotësuese që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë cdo veprim tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, cdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim me objektin parësor të Shoqërisë.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në regjistrin e shoqërive tregëtare deri sa të mbyllet me akte ligjore.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 150.000 ALL (njqind e pesedhjetë mije lek) dhe është i përbërë nga 100 (njqind) kuota.

Kapitali themeltar zotërohet si më poshtë:

- **Shpëtim Shijaku** zotëron 100 (njqind) kuota që perfaqësojnë 100% (njqind) të kapitalit, me vlerë nominale 150.000 (Njqind e pesedhjetë mije leke).

NENI 6

KALIMI I KUOTAVE

Pjeset e kapitalit themeltar jane nominative dhe te ndashme sipas ligjit. Te drejtat, perfshire edhe e drejta e votes, u takojne ortakeve ne perpjestim me perqindjet qe secili zoteron ne kapitalin themeltar.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Ne rastin e kalimit te kuotave ne favor te te treteve, ortakeve te tjere te shoqerise nuk u takon e drejta e parablerjes.

NENI 7

VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos mbi çeshtjet qe i rezervohen kompetences se saj nga ligji dhe nga ky Statut .

Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos me shumice te zakonshme te votave te ortakeve pjesemarres ne lidhje me te gjitha çeshtjet qe nuk kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 8 te ketij statuti, ne rast se ne asamble marrin pjese ortakët qe zoterojne te pakten ose me shume se 30% (tridhjetë perqind) te kuotave.





NENI 8

VENDIMET ME SHUMICE TE KUALIFIKUAR

Asambleja e Pergjithshme e ortakeve vendos me shumice te kualifikuar te votave te ortakeve, mbi ndryshimet e ketij Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Ne asnje rast, shumica nuk mund te detyroje ndonje prej ortakeve te zmadhoje angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 9

THIRRJA E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e pergjithshme e ortakeve e thirrur ne menyre te rregullt perfaqeson teresine e ortakeve dhe vendimet e saj, te marra konform ligjit dhe ketij statuti, jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, edhe nese keta mungojne ose nuk jane te te njejtë mendim.

Asambleja thirret nga administratori nepermjet njoftimi me shkrese derguar ortakeve dhe nepermjet postes elektronike.

Ne njoftimin e thirrjes duhet te tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e çështjeve qe do te trajtohen. Ne mungese te formaliteteve te mesiperme, asambleja e pergjithshme e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord per te marre vendime pavaresisht parregullsise ne thirrje.

Ortaket kane te drejten e pjesëmarrjes ne asamble dhe gezojne te drejten e votes ne perpjestim me pjesëmarrjen e secilit prej tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Vendimet e asamblese se pergjithshme te ortakeve duhet te regjistrohen ne procesverbalin e nenshkruar nga kryetari dhe mbajtesi i procesverbalit.

NENI 10

ADMINISTRIMI I SHOQERISE


Organi i vetem Administrativ i shoqerise eshte Administratori i saj i vetem:

- **Z.Florjan Almadhi**, shtetas shqiptar, lindur më 15.02.1989 në Tiranë e banues në Tiranë, mbajtës i Leternjoftimit ID me Nr.035562482 dhe me numër personal I90215063D, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

qe do te qendroje ne detyre per nje periudhe prej 5 vjetesh me te drejte rizgjedhjeje.

Administratoret qendrojne ne detyre per periudhen e caktuar nga ortaket ne momentin e emerimit ose, ne mungese percaktimi, deri ne doreheqjen ose shkarkimin e tyre dhe mund te rizgjidhen.

Nuk mund te emerohen ne detyren e administratorit dhe, nese jane emeruar, duhet te shkarkohen, personat te cileve u eshte hequr ose kufizuar aftesia per te vepruar, kane

falimentuar ose u është ndaluar, edhe perkohesisht, e drejta për të ushtruar funksione publike ose detyra drejtuese pranë personave juridike, si rrjedhojë e një vendimi penal.

Cdo emerim që bëhet ndesh me paragrafet e sipërpermendur nuk do të konsiderohet si konflikt interesi nëse mer votëbesimin e të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqinde) të ortakeve.

Në rast emerimi për një afat të caktuar, detyra e tyre perfundon në datën e asamblesë së thirrur për miratimin e bilancit të vitit të fundit ushtrimor të mandatit të tyre.

Perfundimi i mandatit të administratorit për shkak të perfundimit të afatit ka efekt nga momenti i riformimit të organit administrativ.

NENI 11

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshem të shoqërisë, në përputhje me sa është parashikuar nga ligji, nga akti i themelimit dhe nga ky statut. Ai gëzon të drejta dhe fuqi të plota për kryerjen e çdo veprimi që vlerësohet i dobishëm për realizimin e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që duhet të merren me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakeve. Në mënyrë të veçantë, hyjnë në kompetencat e organit administrativ veprimtaritë e mëposhtme :


- a) Hartimi i inventarit, llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, në mbylljen e çdo viti financiar;
- b) Hartimi i projekteve të bashkimit dhe ndarjes së shoqërisë;
- c) Propozimi për celjen apo mbylljen e degeve, filialeve, zyrave të perfaqësimit të shoqërisë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- d) Perfaqëson Shoqërinë përpara i përket Lidhjeve të Kontratave Lokale, Kombëtare apo Ndërkombëtare, përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja
- e) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- f) Ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem;
- g) Ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie ekonomike me të tretet në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, tërheqje, transferata, etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vëndore, Zyrave të Punes, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë

Administratoret mund të emerojnë perfaqësues të posaçëm për kryerjen e akteve të veçanta ose të një kategorie aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse.

NENI 12

PERFAQESIMI





Administratori ushtron i vetem perfaqesimin e pergjithshem te shoqerise kundrejt te treteve siperpermendur, si dhe gjithashtu dhe ne gjykim. Ai mund te caktoj avokate dhe perfaqesues te shoqerise perpara organeve gjyqesore, organeve te administrates shteterore dhe te treteve, si dhe perfaqesues te posaçem per akte te veçanta ose kategori aktesh noteriale.

NENI 13

VITI USHTRIMOR DHE BILANCI

Viti ushtrimor fillon me 01 janar dhe mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti.

Ne fund te çdo viti ushtrimor, organi administrativ procedon me hartimin e bilancit te vitit ushtrimor, brenda afateve dhe ne perputhje me dispozitat e ligjit.

Dokumentat e kontabilitetit, te shoqeruar, nese jane te nevojshem, nga raporti i eksperteve kontabel te autorizuar duhet tu komunikohen dhe tu vihen ne dispozicion ortakeve prane selise se shoqerise te pakten pesembdhjete dite perpara dates se Asamblese.

Viti i pare ushtrimor fillon ne daten e themelimit te shoqerise dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti.

NENI 14

FINANCIMI I ORTAKEVE

Shoqeria mund te marre nga ortaket kontribute ne te holla dhe hua, me ose pa kamate, ne perputhje me dispozitat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Dhenia e ketyre financimeve nga ana e ortakeve eshte e lire.

NENI 15

PRISHJA E SHOQERISE

Prishja e shoqerise vendoset nga Asambleja e pergjithshme e ortakeve me shumicat e parashikuara per ndryshimin e ketij statuti per nje nga shkaqet e meposhtme:

- 1) pamundesi te funksionimit ose mosfunksionim te vazhdueshem te asamblese;
- 2) me vendim te asamblese se ortakeve;
- 3) per shkaqe te tjera te parashikuara me ligj.

NENI 16

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet ortakeve ose ndermjet ortakeve dhe shoqerise dhe qe ka objekt te drejta te disponueshme ne lidhje me marredheniet e tyre me shoqerine do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 17

LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM





Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të disiplinohet nga dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, për sa të aplikueshme.

Ky statut u hartua në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet rregullisht nga ortaku i shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Shpëtim Shijaku

